

Më
Dana 23-02-2018 NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Pergjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtarin Ligjor Blend Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED], nga fshati [REDACTED], Komuna [REDACTED], për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2340-5/2015 e dt.19.09.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani të dëmtuarit [REDACTED] dhe të akuzuarit [REDACTED], me dt.17.01.2018 solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED], nga fshati [REDACTED], Komuna [REDACTED], i lindur me [REDACTED], në [REDACTED], nga i ati [REDACTED], dhe e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i tre fëmijëve i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në liri me numër personal [REDACTED],-

ËSHTË FAJTORË

SEPSE:

- me dt. 27.22.2015 rreth orës 13.45, në rrugën magjistrale Ferizaj Gjilan, në fshatin Sojevë, afër restorantit “ Natyral ”, deri sa ishte duke vozitur me veturen e markës “ Mercedes 190 ” me ngjyrë hyri me targë të regjistrimit [REDACTED], duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nen 55/1 të LSKRR nga pakujdesia ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë duke mos përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kshteve të rrugës e cila ishte e mbuluar me borë humbë kontrollin e drejtimit të lëvizjes dhe kalon në shiritin e kundërt ku me pjesen e pasme të djathtë ndeshet nga pjesa e përparme e automjetit transportues “ Opel Vivara “, me targë të regjistrimit [REDACTED] të cilën ishte duke drejtuar [REDACTED] dhe i cili ka qenë duke lëvizur nga drejtimi Ferizaj-Gjilan, ndërsa mbrapa tij duke lëvizur automjeti “ VW Caddy “me trag të regjistrimit [REDACTED], të cilën e drejtonte [REDACTED] i cili nuk arriti me kohë ta ndalë automjetin “ VW Golf “, i cili nga inercioni i goditjes me pjesen e përparme përplasat me pjesen e pasme të automjetit transportues “ Opel Vivara ”, ku përveç dëmeve materiale lëndime trupore ka pësuar pasagjeri në veturën “ Mercedes 1909 “, [REDACTED], ndërsa tek vetura “ VW Golf “ janë shkaktuar vetëm dëme materiale për lëndime trupore,-

-Me këtë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga nen.378 par.6 lidhur me par.1 të KPK-së.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së

G J Y K O N

Të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënimin mr gjobë në shumë prej 100 /njëqind / Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan, në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin në të holla, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Të dëmtuarit [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rruga "[REDAKTUAR]", [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rruga "[REDAKTUAR]", [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rruga "[REDAKTUAR]", për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60,88 Euro si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.2340-5/2015 e dt.19.09.2017, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.17.01.2018 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, i dëmtuari [REDAKTUAR], dhe i akuzuari [REDAKTUAR].

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drerjtat e të akuzuarit janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar atakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDACTED] ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën më ngarkon aktakuza dhe në vazhdim ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës që ka dhënë në polici me datë 27.11.2015 atë ditë ishte duke vozitur në rrugën magjistrale prej drejtimit të Gjilanit në drejtim të Ferizajit dhe me të arritur në fshatin Sojevë Komuna e Ferizajit afër restorantit "Natyrali" me që rruga ishte me borë për njëherë i ka humbur kontrollin mbi timon dhe ka kaluar në anën e kundërt të lëvizjes ku në atë momentë nga drejtimi i kundërt ka ardhur një automjetë dhe me pjesën e përparme ka goditur në pjesën e pasme ku si pasojë e këtij aksidenti pos dëmeve materiale lëndime trupore ka marrë pasagjeri i tij vllau është përnduar për veprën e kryer, i ka shpreh keqardhje të dëmtuarëve tjerë për lëndimet që kanë pësuar dhe dëmet materiale i ka propozuar gjykatës që me rastin shqiptimit të denimit të marrë për bazë gjendjen e tij ekonomike është mbajtës i familjes dhe në të ardhmen do të jetë me i kujdesshëm në komunikacion.

Gjyqtari në kuptim nën paragraf 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe paragraf 4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 paragraf 2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Prokurri i shtetit Ismet Rrahmani ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe me rastin e shqiptimit të denimit gjykata të marrë për bazë pranimin e fajësisë pendimin për verën e kryer dhe se në këtë amcitet lëndime ka pësuar edhe vllau i tij që ishte në vetur me të dhe se të dëmtuarit nuk i bashkangjiten ndekjes penale.

I dëmtuari [REDACTED] në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndekjes penale por ka mbetur pranë kërkesë pasuroro-juridike.

~~I dëmtuari [REDACTED], në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndekjes penale por ka mbetur pranë kërkesë pasuroro-juridike.~~

I dëmtuari [REDACTED], në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndekjes penale por ka mbetur pranë kërkesë pasuroro-juridike.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale gjegjësisht në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të mjekësisë ligjore të dt.19.05.2017, në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit të dt.19.05.2017, deklaratën e të pandehurit dhënë në hetuesi me datën 27.11.2015, delaratën e të dëmtuarëve dhënë në hetuesi me datën 27.11.2015 si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragraf 6 lidhur me paragraf 1 të KPPK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshtë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojinë dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka treguar sinqeritet në procedurën penale, i ka kërkuar falje te dëmtuarit ne shqyrtimin fillestar, për te dëmtuarin qe nga aksidenti ka ndi një shqetësim dhe është interesuar për gjendjen shëndetësorë të dëmtuarëve, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim me gjobë, si në dispozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarit [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], Komuna [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rruga "[REDAKTUAR]", [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rruga "[REDAKTUAR]", [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rruga "[REDAKTUAR]", për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.


Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së gjykata ka obliguar të akuzuarin që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60,88 Euro si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal,
P.nr.2359/2017 me datë 17.01.2018

Zyrtar Ligjor
Blend Rexhepie

Gjyqtari
Adem Shabani



KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar, ankesa në afat prej 15 ditësh. nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.